



# USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 5 (827756)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 Shkurt 2022

SHSHP të FA, priti në takim Komandantin  
e Brigadës së Europës Juglindore

**Gjeneralmajor Begaj: Shqipëria do të  
vazhdojë t'i qëndrojë kontributeve të saj të  
deklaruar si pjesë e iniciativës së "SEEBRIG"**



» faqe 3



## 30-VJET POLICI USHTARAKE

**Ministri Peleshi: Mirënjohje gjithë grave  
dhe burrave që kanë shërbyer dhe ngritur  
lart emrin e Policisë Ushtarake**



**Gjeneralmajor Begaj: Në tre dekada  
rrugëtim, një histori suksesi në  
përballje me vështirësi dhe sfida**



**Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc.  
Bajram Begaj, i ka akorduar Batalionit të Policisë Ushtarake medaljen  
"Repart i Shquar", me motivacionin "Për trimëri dhe vendosmëri të  
lartë gjatë përmbushjes së misionit, përmes vështirësive të mëdha"**

» faqe 4-5





## Vizitë e SEEBRIG në Forcën Tokësore

Një ekip i Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG), i kryesuar nga komandanti i kësaj njësie gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos dhe pjesëtarë të shtabit të saj, zhvilluan këtë të martë një vizitë vlerësuese në Forcën Tokësore.

Gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos, u prit fillimisht nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Më pas, ekipi i vlerësimit vijoi axhendën e vizitës në Forcën Tokësore, me inspektimin e Kompanisë I të Batalionit II të Këmbësorisë së FT (b2kFT), nënrepart ky, i cili së bashku me Kompaninë e Xhenios së Batalionit të Mbështetjes me Luftim (bML) janë deklaruar si pjesë e Brigadës së Europës Juglindore.

Në takimet e zhvilluara me komandat respektive të të dyja reparteve, nëpërmjet prezantimeve të organizuara më këtë rast, ata u njohën me aktivitetet kryesore, trajnimet, stërvitjet dhe misionet brenda dhe jashtë vendit të zhvilluara nga këta efektivë.

Vizita vlerësuese e SEEBRIG, u fokusua në çështjet e personelit, organizimit, mjekësisë, operacioneve dhe stërvitjes, komunikimit, pajisjeve të xhenios dhe në vlerësimin e kapaciteteve operacionale të dy nënrepartëve të dedikuara në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP), fatkeqësive natyrore, në përputhje me direktivat, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) dhe planet operacionale të përgjithshme të SEEBRIG.

Për të gjitha këto çështje, ekipi vlerësues i SEEBRIG inspektoi nga afër armatimin,

pajisjet dhe mjetet që kanë në përdorim personeli i nënrepartëve, të deklaruar si pjesë e Brigadës së Europës Juglindore, duke ndjekur

njëkohësisht edhe disa demonstrime praktike në terren nga trupat b2k dhe bML të Forcës Tokësore. Në përfundim të vizitës, koman-

danti i SEEBRIG gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos, falënderoi efektivët e Forcës Tokësore, për angazhimin e tyre gjatë zhvillimit

të demonstrimeve stërvitore dhe i inkurajoi që standardet e arritura, jo vetëm t'i ruajnë, por t'i ngrenë edhe më lart.

# Komandanti i SEEBRIG Iliopoulos: Standardet e arritura, jo vetëm t'i ruajnë, por t'i ngrenë edhe më lart





## SHSHP të FA, priti në takim Komandantin e Brigadës së Europës Juglindore

# Gjeneralmajor Begaj: Shqipëria do të vazhdojë t'i qëndrojë kontributeve të saj të deklaruara si pjesë e iniciativës së "SEEBRIG"

*Gjeneral brigade Iliopoulos vlerësoi maksimalisht gatishmërinë e treguar nga pala jonë për përgatitjen e nënrepartëve të FARSH, por edhe për gatishmërinë e treguar për pjesëmarrjen në stërvitjen Seven Stars-22, drejtuar nga SEEBRIG*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, priti në një takim Komandantin e Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG), gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos.

Ekipi i drejtuar nga gjeneral brigade Iliopoulos po zhvillon një vizitë vlerësuese në vendin tonë me qëllim inspektimin e nënrepartëve të deklaruara nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e SEEBRIG.

Fokusi i këtij vlerësimi është personeli, organizimi, stërvitja, si dhe kapacitetet operacionale të nënrepartëve të FARSH, të caktuara për të marrë pjesë në operacionet e Mbështetjes së Paqes dhe në përgjigje të fatkeqësive natyrore apo emergjencave civile.

Gjeneral brigade Iliopoulos falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm për pritjen e organizuar si dhe bëri një pasqyrim të misionit, detyrave dhe angazhimeve të Komandës së SEEBRIG.

Ai më tej vlerësoi maksimalisht gatishmërinë e treguar nga pala jonë për përgatitjen e nënrepartëve të FARSH për këtë inspektim periodik por edhe për gatishmërinë e treguar për pjesëmarrjen në stërvitjen Seven Stars-22, drejtuar nga SEEBRIG. "Kapacitetet dhe operacionaliteti i njësisë të FARSH, gatishmëria operacionale, niveli i stërvitjes dhe trajnimeve, paraqesin një vlerë të shtuar dhe janë një kapacitet i vyer për t'u përdorur nga komanda e SEEBRIG", -theksoi ndër të tjera gjeneral brigade Iliopoulos.

Gjeneralmajor Begaj, nga ana e tij, vlerësoi rolin e komandantit të SEEBRIG gjeneral brigade Iliopoulos por edhe të komandës në tërësi, si një histori e suksesshme për të gjitha arritjet dhe rezultatet e treguara gjatë gjithë këtyre viteve. Shqipëria do të vazhdojë t'i qëndrojë kontributeve të saj të deklaruara si pjesë e kësaj iniciative, dhe se ky vlerësim që po zhvillohet do të shërbejë më tej për forcimin e kapaciteteve ushtarake. "SEEBRIG po kthehet në një platformë të veçantë për bashkëpunimin, trajnimin e ndërsjellë, shkëmbimin e ideve dhe mësimëve të nxjerra. Kontributi i saj për sigurinë dhe stabilitetin rajonal mbetet vendimtar për rajonin tonë", -theksoi ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Forca Shumëkombëshe e Paqes në Europën Juglindore përbëhet nga 7 vende anëtare, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Turqia dhe 5 vende vëzhguese, SHBA, Ukraina, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia dhe Kroacia. Misioni i SEEBRIG është pjesëmarrja në Operacionet Paqeruajtëse si dhe në operacione kundër fatkeqësive natyrore dhe njerëzore. SEEBRIG është pjesë e strukturave të mundshme në mbështetje të Operacioneve së Paqes të drejtuara nga NATO ose BE. Në korrik 2009, SEEBRIG është drejtuar nga një gjeneral shqiptar, gjeneral brigade Zyber Dushku, për një mandat 2-vjeçar. Aktualisht në shtabin e brigadës shërbejnë një numër ushtarakësh shqiptarë në nivel shtabi si edhe në pozicione të larta.



## Shpërndahen ndihma ushqimore për zonat e thella të qarkut Shkodër

Mbi 500 pako kryesisht me ushqime dhe detergjentë u shpërndanë nga Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile në bashkitë Pukë dhe Malësi e Madhe. Pakot ushqimore u siguruan nga Rezervat Materiale të Shtetit pas kërkesës së bërë nga kryetarët e këtyre bashkive dhe prefektja e qarkut Shkodër Majlinda Angoni.

Konkretisht, në bashkinë Pukë u transportuan 300 pako, ndërsa në atë të Malësisë së Madhe 205 të tilla. Pakot në këto zona të thella u dërguan në ndihmë të familjeve në nevojë, ato me probleme sociale, shëndetësore apo të moshuar që jetojnë vetëm dhe që kanë hasur vështirësi të theksuara nga moti i ashpër dhe temperaturat e ulëta. Në bashkinë Malësi e Madhe pakot u dërguan në njësinë administrative Kelmend ku ishin të pranishëm prefektja e qarkut Shkodër Majlinda Angoni dhe kryetari i bashkisë Tonin Marinaj. Prefektja e Shkodrës theksoi mbështetjen e autoriteteve, jo vetëm për banorët e fshatrave të thellë të qarkut, por edhe për bagëtitë e tyre gjatë këtyre ditëve me reshje bore dhe temperatura ekstreme: "Menjëherë sapo morëm njoftimin për situatën e vështirë në të cilën ndodheshin disa familje, bëmë të mundur që brenda 24 orëve ne t'i përgjigjemi nevojave konkrete. Ne kemi një situatë të tillë emergjente edhe në Pukë ku kemi dërguar një sasi paketash



ushqimore sipas kërkesave të banorëve që ndodhen në vështirësi. Në rang qarku janë shpërndarë 507 pako ushqimore, po kështu edhe detergjentë. Pritet të vijë edhe një sasi bazë ushqimore për gjënë e gjallë." - u shpreh prefektja Angoni.

Pakot iu dorëzuan kryetarëve të tetë fshatrave

të Kelmendit, siç janë Vermosh, Lëpushë, Selcë, Tamarë, Brojë, Kozhnje, Nikç, dhe Vukël, për t'iu shpërndarë më pas banorëve në shtëpitë e tyre, ndërsa në Pukë pakot u shpërndanë për fshatrat e thellë të njësisë administrative Qelëz, Qerret, Gjeggjan dhe Rrapë



MINISTRI PELESHI URON NË 30-VJETORIN E KRIJIMIT TË SAJ EFEKTIVËT E POLICISË USHTARAKE

## Ministri Peleshi: Mirënjohje gjithë grave dhe burrave që kanë shërbyer dhe ngritur lart emrin e Policisë Ushtarake



Policia Ushtarake përgjatë 30 viteve të historisë së saj ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave tona të Armatosura. E ka treguar këtë gjatë konfliktit në Kosovë, misioneve ndërkombëtare, por edhe stërvitjeve masive në vendin tonë, siç ishte “Defender Europe 21”.

Mirënjohje gjithë grave dhe burrave që kanë shërbyer dhe ngritur lart emrin e Policisë Ushtarake.

Krenar për të gjitha sfidat e kaluara me sukses në këtë rrugëtim të vështirë.



## Policia Ushtarake kremton 30-vjetorin e krijimit të saj

# Gjeneralmajor Begaj: Në tre dekada rrugëtim, një histori suksesi në përballje me vështirësi dhe sfida

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, i ka akorduar Batalionit të Policisë Ushtarake medaljen “Repart i Shquar”, me motivacionin “Për trimëri dhe vendosmëri të lartë gjatë përmbushjes së misionit, përmes vështirësive të mëdha”*

Në 30-vjetorin e krijimit të Policisë Ushtarake, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, i ka akorduar Batalionit të Policisë Ushtarake medaljen “Repart i Shquar”, me motivacionin “Për trimëri dhe vendosmëri të lartë gjatë përmbushjes së misionit, përmes vështirësive të mëdha”.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantët e forcave, deputetë të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, ish-komandantë të Policisë Ushtarake, si dhe të ftuar të tjerë.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, në përshëndetjen e rastit, pasi falënderoi të gjithë të pranishmit u shpreh ndër të tjera: “Ndjem i respektuar t’ju drejtohem dhe të përshëndes sot efektivët e shërbimit të Policisë Ushtarake, në këtë përvjetor të 30-të. Megjithatë shërbimi më i ri në Forcat e Armatosura, Policia Ushtarake ka treguar konsolidim, integritet, kohezion dhe dinamizëm në kryerjen e detyrave të saj. Ju duhet të ndjeheni krenar për këtë. Në tre dekada rrugëtim, ne e vlerësojmë policinë tonë një histori suksesi në përballje me vështirësi dhe sfida, me aktivitet dhe kontribut të prekshëm në mbështetje të suksesit të aktivitetit dhe detyrave të Forcave të Armatosura”.

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj u ndal në gjeografinë e angazhimeve të Policisë Ushtarake të cilat kanë kapërcyer kufijtë e vendit, duke qenë prej kohësh dhe aktualisht pjesë organike e misioneve të FARSH, duke filluar nga Afganistani, në Çad dhe Egje, KFOR e kudo që është kërkuar në plotësim të detyrimeve euroatlantike të vendit, në kuadër



të NATO-s dhe formateve të tjera. “Aktualisht Policia Ushtarake ka angazhimin më të madh të Forcave tona të Armatosura në kuadër të Operacionit “Allied Solace” të Aleancës për menaxhimin e kampit të refugjatëve afgan në Kosovë. Kjo është një vlerë e shtuar dhe kontribut i çmuar”, - u shpreh gjeneralmajor Begaj.

Aktiviteti vijoi me dhënien e dy medaljeve të akorduara nga shefi i

Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj “Për Shërbim të Vecantë” për efektivë të Policisë Ushtarake, si dhe me ceremoninë e vënies së emrit “Namik Goga” të një prej ambienteve të godinës së Komandës, në kujtim të sakrificave dhe punës së ish-efektivëve të Policisë Ushtarake.

Në përmbyllje, efektivë të Policisë Ushtarake demonstuan disa nga pajisjet dhe aftësitë e tyre

nëpërmjet ushtrimeve stërvitore.

30 vite histori suksesi, Policia Ushtarake dhe drejtuesit e saj në vite

Policia Ushtarake pjesë e Forcave të Armatosura u formua, më 1 shkurt 1992, pas miratimit në Parlament të Ligjit nr. 511, datë 08.08.1991, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Pas viteve '90, ashtu si në të gjithë

vendin edhe në FA u kryen një sërë reformash. Ndër to përmendim: miratimin e akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i Policisë Ushtarake (PU) në përbërje të FA-së. Formimi i kësaj strukture kishte si qëllim forcimin e rregullit dhe të disiplinës në FA dhe u pa si domosdoshmëri për transformimin e ushtrisë sipas standardeve të vendeve të NATO.

Me krijimin e PU-së, objekti i punës së saj ishte kontrolli i trafikut ushtarak, ruajtja e rendit ushtarak në FA, me synim forcimin e disiplinës ushtarake në FA. Në dhjetor të vitit 1994, me Urdhër nr. 482, datë 10.12.1994 të MM, “Për organizimin e Policisë Ushtarake”, strukturës së PU-së iu bashkëngjiti struktura e Policisë Kriminale dhe ajo e Mbrojtjes nga Zjarri. Në fillim të vitit 1995, me Urdhër nr. 205, datë 10.04.1995 të MM, “Për vartësinë dhe funksionimin e Policisë Ushtarake”, dega e PU-së në SHP u transformua në drejtori të PU-së, me drejtor gjeneral brigade Bajram Malaj. Me mbështetje ligjore, nënligjore si dhe me profesionalizëm gjithnjë në rritje, PU u radhit ndër repartet më të mira të FA-së. Pas ngjarjeve të vitit 1997, drejtori i Drejtorisë së PU-së ishte kolonel Piro Lutaj. Edhe pas ngjarjeve të





vitit 1997, PU pati një rritje të jashtëzakonshme mbi bazën e një projekti me Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE). Në këtë kohë për herë të parë, me asistencën e specialistëve italianë u krijua batalioni i PU-së në Tiranë, i cili u kompletua me bazën materiale e logjistike të nevojshme dhe u konceptua sipas modelit të batalioneve të karabinierisë italiane. Krijimi i batalionit të PU-së në Tiranë, shënon një hap cilësor në veprimtarinë e kësaj strukture moderne dhe nga më cilësore të kohës, gjë që u duk qartë në ngjarjet e vitit 1998, kur PU jo vetëm që nuk u dëmtua por ajo mori në ruajtje disa nga institucionet kryesore të shtetit si: Radio Televizioni Shqiptar, Telekom-in, Prokurorinë e Përgjithshme si dhe disa institucione ndërkombëtare.

Në këtë periudhë, PU ishte një nga institucionet e pakta moderne që ishte ndërtuar deri në atë kohë dhe që ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në rivendosjen e shtetit ligjor në Shqipëri.

Kompletimi i batalionit të PU-së në Tiranë, me teknikën e nevojshme dhe automjete të blinduar tip IVECO-90, luajti një rol të jashtëzakonshëm në ngjarjet e vitit 1998 në Shqipëri. I pamohueshëm mbetet roli i kësaj strukture në vitin 1999, në kohën e krizës së Kosovës, ku PU mbajti peshën kryesore në pritjen, shoqërimin, trajtimin e refugjatëve pranë kampingjeve të ngritura në Kukës, Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera të vendit, mbajtjen nën kontroll të situatës në zonat Kukës, Krumë, Tropojë, sidomos pranë postave kufitare, duke zgjidhur mjaft situata të vështira, shoqërimin e mjaft autokolonave dhe personaliteteve që lëviznin për në veri dhe kthim, si dhe mbajtjen nën kontroll të rrjetit rrugor në të gjithë vendin e veçanërisht në veri. Ngjarjet e vitit 1997, 1998 dhe ato të krizës kosovare janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e PU-së.

Për kryerjen e këtyre detyrave, PU u mbështet dhe në miratimin e Ligjit nr. 8404, datë 15.09.1998,

për një shtesë në Ligjin nr. 7978, datë 26.07.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në fund të vitit 2000, me suprimimin e strukturës së Drejtorisë së Policisë Ushtarake, me Urdhër nr. 1, datë 05.01.2001 të MM, “Për organizimin e regjimentit të Policisë Ushtarake”, u krijua regjimenti i PU-së me komandant nënkolonel Namik Goga. Kjo strukturë e ushtri aktivitetin e saj deri në shtator të vitit 2003, duke bërë ruajtjen dhe sigurimin e të gjitha stërvitjeve që zhvilloheshin në territorin e vendit tonë.

Në shtator të vitit 2003, mbi bazën e Ligjit nr. 8930, datë

drejtimi administrativ në Komandën Mbështetëse dhe Komandim Operacional nga SHPFA

Në qershor të 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Syrja Gjoka.

Në gusht të 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Ylli Zyla.

Në shtator të 2013, komandant i PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli.

Veprimtaria e PU-së përcaktohet nga misioni dhe detyrat që parashikohen në ligjin, “Për Policinë Ushtarake në FARSH” dhe “Kodi Penal Ushtarak”. Hartimi dhe miratimi në Kuvend i këtij ligji në vitin 2003, shënon një ristrukturim të plotë të kësaj

i PU-së ka dhënë në emergjencat civile, ku kanë treguar gatishmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e detyrave të marra.

Tashmë, struktura e PU-së është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit, detyrave, si edhe të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare.

Policia Ushtarake është njësi në varësi të Shtabit të Përgjithshëm.

Policia Ushtarake ka në misionin e saj ruajtjen e rendit ushtarak në FARSH, zbulimin, parandalimin, ndjekjen e veprimtarisë kriminale, angazhimin në luftën kundër terrorizmit,

- Punon për zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të FA-së, pronës dhe objekteve ushtarake.

- Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen dhe sjelljen forcërisht të ushtarakëve që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit.

- Kontrollon dhe siguron transportin ushtarak.

- Kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe teknikës ushtarake.

- Kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit



25.07.2002, “Strategjia Ushtarake e RSH”, struktura e PU-së me Urdhër nr. 214, datë 21.08.2003 të MM, “Për organizimin e Regjimentit të Policisë Ushtarake”, u transformua në strukturën e batalionit me qendër në Tiranë, me komandant batalioni nënkolonel Xhevahir Abdia, i cili e ushtri detyrën deri në vitin 2005. Në vitin 2005 komandant batalioni u emërua nënkolonel Drini Nikolla, i cili e ushtri ketë detyrë deri në vitin 2008.

Në korrik të vitit 2007, në bazë të Urdhrit nr. 15, datë 17.01.2007 të MM, “Për ristrukturimin e Forcave të Armatosura”, batalioni i PU-së ishte pjesë organike e Komandës Mbështetëse, me varësi

strukture.

Gjatë kësaj periudhe është punuar për kompletimin e PU me personel të motivuar, arsimuar në vendet anëtare të NATO, si në Turqi, Itali, Gjermani. Realizimi i misionit dhe detyrave funksionale është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore.

Gjatë këtyre viteve PU, është trajnuar nga specialistë të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke.

Gjithashtu, PU ka kryer një mision në operacionin ushtarak “ISAF”, në Kabul, Afganistan. Kontingjenti i kësaj toge përbëhej nga një efektiv prej 22 vetash.

Një kontribut të madh, efektivi



marrjen pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së nga veprimet e kundërligjshme.

#### Detyrat

- Siguron rendin ushtarak jashtë repartëve ushtarake në mjediset publike e jopublike.

- Mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm kur ato cenohen për shkak të detyrës.

- Mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së nga veprimtari të kundërligjshme.

- Ndërhyn për të mënjanuar aktet e terrorizmit në FA.

të Masat e Ndërhyrjes kundra Zjarrit (MNZ).

- Siguron zbatimin e rendit ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, veprimtarisë dhe ceremonive ushtarake të organizuara nga SHPFA.

- Shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të FA-së, si dhe delegacionet e huaja të njehsuara me to.

- Kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake që veprojnë në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Kryen e mbështet operacionet humanitare.



# Domeni patriarkal i familjes shqiptare

Përgatiti: Shefe e Sektorit  
të Botimeve Anjeza Musollari

Në patriarkalin tradicional familja e burrit është kreu i saj i padiskutueshëm, theksoj varësinë e gruas nga burri i saj dhe fëmijët nga prindërit. Autoriteti mashkull njihet pa asnjë pyetje ose pranohet nën presion. Dominimi i autoriteteve atërore është i pakufizuar. Autoriteti i anëtarëve të tjerë të familjes varet nga seksi dhe mosha e tyre: njerëzit më të nderuar të moshuarit, burrat kanë të drejta me të mëdha se gratë. Interesat e klaneve mbizotërojnë mbi individin. Prandaj, një familje e tillë quhet patriarkal. Burri ka kontribut themelor në mbështetjen materiale të familjes, siguron burimet e saj financiare dhe ekonomike, përcakton statusin dhe rrethin e saj të komunikimit, miraton vendimet përgjegjëse për çështjet më të rëndësishme, ai rregullon mosmarrëveshjet. Bashkëshorti është i përjashtuar nga detyrimet në shtëpi, gruaja është ose një amvisë, ose fiton shumë pak. Në shpatullat e saj ka një organizim normal të jetës dhe të konsumit, të krijojë një mjedis komod dhe të rehatshëm në shtëpi. Përgjegjësitë e saj gjithashtu përfshijnë fëmijët dhe edukimin e tyre. Në versionin e saj klasik, familja patriarkale karakterizohet shkurtimisht si më poshtë:

-Burri është kapitulli i vetëm dhe mbrojtësi i familjes, përlësia e grave është borxhi natyror ndaj bashkëshortit. Martesa u perceptua si një shtet i themeluar nga Perëndia, në të cilin një burrë dhe një grua jetojnë së bashku, në mirëkuptim të ndërsjellë, duke lindur pasardhësit e tyre.

-Martesa në sytë e shoqërisë fitoi tiparet e qëndrueshmërisë. Vitaliteti i martesës u përcaktua nga objektivat pragmatike: ai lejoi të forcojë pozicionet materiale të familjes së burrit. Imazhi i famshëm patriarkal-Gruaja e virtutshme.

-Veprimtaria shoqërore e gruas ishte e kufizuar në rrethin e çështjeve të brendshme dhe kujdesin e përditshëm për nevojat shpirtërore dhe fizike të fëmijëve. Edukimin e fëmijëve të nevojshëm në bindje.

- cilësitë më të mira të grave ishin njohja e statusit dhe shërbimit të varur në martesë me burrin e saj, kuptimi i seksualitetit femëror u pa në lindjen e fëmijës.

Psikoanalisti i shquar Wilhelm Reich, në studimin e tij “Psikologjia e masave dhe fashizmit”, shprehu pikëpamjen e tij: “... një shoqëri autoritare riprodhohet në strukturat individuale të masave me ndihmën e një familjeje autoritare ... në fytyrën e babait, Shteti autoritar



ka përfaqësuesin e saj në secilën familje dhe për këtë arsye familja kthehet në mjetin më të rëndësishëm të fuqisë së tij”. Për djemtë, identifikimi i thellë me babanë e tij shërben si bazë për identifikimin emocional me çdo formë të autoritetit. Në një familje autoritare nuk ka vetëm konkurrencë të të rriturve dhe fëmijëve, por edhe konkurrencë midis fëmijëve në marrëdhëniet e tyre me prindërit, të cilat mund të kenë pasoja më serioze.

Deri në mes të shekullit XX vlerat tradicionale mbajnë ndikimin e tyre në Europë dhe Azi. Por procesi i transformimit të familjes në “patriarkal” ka fituar në mënyrë të qëndrueshme forcë. Në vitet ‘50, në Europën e pasluftës, duke dobësuar departamentet e baballarëve në pothuajse të gjitha shtresat shoqërore. Miratimi/refuzimi i modelit patriarkal nga bashkëkohësit përcaktohet kryesisht nga rënia e varësisë sociale dhe ekonomike e gruas nga burri i saj.

## A vazhdon të jetë ky fenomen pjesë e familjes shqiptare?

Familja si njësi konservatore, veçanërisht në fshat, doli në tregun e lirë, ku gruaja filloi të fitojë pavarësi ndaj burrit dhe gradualisht po humbet pushteti patriarkal në familje. Familjet që erdhën në zonat urbane, duke braktisur fshatin, u çliruan nga opinioni i fisit apo komunitetit rural. Veçanërisht largimi i rinisë në emigracion është një nga plagët më të rënda që kontradiktat burrë grua, sot më shumë se kurrë, janë evidente në familjet shqiptare. Shpeshtimi i krimeve që kryejnë burrat ndaj grave faktorizohet nga kushtet ekonomike, sociale, niveli arsimor, kulturor si

dhe mentaliteti e traditat patriarkale që kanë ende terren të një pjesë e mirë e shoqërisë sonë. Familja, si një bashkësi formuese dhe edukuese e personalitetit të njeriut, ka funksione të veçanta të prindërve, vëllezërve, motrave dhe gjyshërve. Edukimi i fëmijëve, arrihet në përsosmëri, kur ka të sinkronizuar kontributet e përbashkëta, të babait dhe nënës. Në shoqërinë e sotme moderne, rezulton se babai është i

iptare është duke kaluar një krizë të madhe. Një krizë, e cila ia ka ndryshuar përgjithmonë fytyrën familjes tradicionale shqiptare. E kaluar është tashmë familja me gjysh, gjyshe, kushërinj e kushërirra. Tashmë familja përbëhet vetëm nga prindërit dhe fëmijët. E kaluar është tashmë familja ku autoriteti i prindit ishte i padiskutueshëm. Familja, e cila dikur ishte e shenjtë, për të cilën

i cili nuk ngjan pothuajse në asgjë me vite më përpara.

Familja shqiptare përjeton sot të gjitha ato dukuri dhe ndryshime që karakterizojnë mbarë shoqërinë shqiptare. Tipari i saj më i përgjithshëm sot është se ajo është një familje në tranzicion. Tiparet e saj dhe problemet me të cilat përballlet ajo janë po ato tipare dhe po ato probleme që shoqërojnë transformimin ekonomik, politik, kulturor e social të shoqërisë shqiptare, me veçoritë që kushtëzon vetë natyra e familjes si një prej institucioneve të shoqërisë.

Ndryshimi i marrëdhënieve martesore, bashkëshortore dhe familjare

Sot, martesat me mblesëri janë bërë një dukuri mjaft e rrallë, që e gjejmë kryesisht në zonat rurale. Po kështu, kanë ndryshuar marrëdhëniet midis burrit dhe gruas për sa i përket rolit, detyrimeve bashkëjetesa zgjidhet si një formë alternative e martesës. Emancipimi i femrave dhe dëshira e tyre për të marrë arsim universitar dhe pasuniversitar, si edhe për të nisur një karrierë profesionale, kanë sjellë si rezultat shtyrjen e moshës mesatare e martesës, si për ato vetë, ashtu edhe për meshkujt. Jeta jonë ka pësuar transformime të mëdha, duke filluar nga koha kur ishin fëmijë gjyshërit dhe prindërit tanë.

Strukturat e familjes kanë pësuar



kërcënuar nga rreziku i tjetërsimit të misionit të tij atëror. Ky mënjanim lidhet me natyrën shoqërore të punës, ku pjesën më të madhe të kohës e kalon jashtë familjes, por edhe për një neglizhencë të pamotivuar të disa baballarëve.

Në vitet e fundit koncepti i familjes, por edhe vetë familja shq-

kanë dalë aq shumë proverba prej popullit, sot nuk ngjan më me të vjetrën. Shndërrimi i shoqërisë, nga një shoqëri tradicionale dhe e mbyllur në një shoqëri të hapur kapitaliste, si dhe ndryshimet rrënjësore sociale e ekonomike, që ishin përfundim i këtij kalimi, krijuan një model të ri të familjes,

transformimet e tyre me kohën, dhe bashkë me të dhe formimi psikologjik dhe njerëzor. U fitua pavarësia e mendimit dhe veprimit brenda anëtarëve të familjes, e cila pati të mirat e saj por dhe me kostot që shpesh sjell liria e pakushtëzuar kur kjo shoqërohet dhe me mungesën e arsimimit dhe formimit intelektual të njeriut.





# Ushtria Shqiptare në periudhën e Republikës së Parë Shqiptare

Përgjegjës i Muzeut të FA-së,  
Dr. ASLLAN ZEMANI

Një vend të veçantë në organizimin e forcës ushtarake kombëtare zë periudha e presidencës së Ahmet Zogut, gjatë së cilës organizimi, detyrat, të drejtat, logjistika, armatimet dhe arsimimi ushtarak u ngritën në një nivel më të lartë. Presidenti Ahmet Zogu suprimoi Ministrinë e Luftës dhe krijoi në vend të saj Komandën e Përgjithshme të Fuqive Armate. Qysh në fillim u përcaktua edhe thelbi i këtij ndryshimi: “Për me largue krejt nga politika” strukturat e armatosura të vendit. Vetë Presidenti do të ishte edhe Komandant i Përgjithshëm i Fuqive Armate, sikurse do të kishte edhe një ushtarak të lartë me detyrën e Zëvendëskomandantit të Përgjithshëm, ose që do të kryente detyrat e përditshme të Komandantit të Përgjithshëm, së bashku me Shtabin Madhor. Thelbi i ndryshimeve ishte ngritja e një ushtrie, e cila të kishte, mundësisht, të gjitha strukturat e një force ushtarake të kohës. Po kështu, ndryshimet synonin forcimin e ushtrisë me bazë doktrinale (rregullore, etj.), si dhe me mbështetje financiare.

Përparësia që iu dha ushtrisë si forcë e sigurisë kombëtare, sidomos në kushtet e përkeqësimit të mundshëm të situatave për shkak të raporteve të ndërlikuara ballkanike e botërore, u shpreh në rritjen drastike të buxhetit për mbrojtjen, i cili arriti shifra deri afro gjysmën e buxhetit të vendit. Përpjekja për largimin e ushtrisë nga politika deri diku ishte një arritje më vete.

Legalizimi i ndryshimeve dhe përfundimi i organizimit të ri ushtarak nën Presidentin Ahmet Zogu, mori formë, më 24 Qershor 1928, me daljen e “Ligjit Organik të Ushtrisë dhe Gjandarmërisë”. Në bazë të këtij ligji përcaktohej forma e or-



ganizimit ushtarak ku përfshiheshin: një komandë divizionit aktiv, Komanda e Divizionit Rezervë, komanda grupesh këmbësorie, Komanda e Artilerisë, Komanda e Trupave Teknike, Komanda e Marinës Luftarake dhe Komanda e Gardës. Sidoqoftë, nisur

dorë për përdorim të menjëhershëm e të përqendruar, dy komandat e para (Komanda e Divizionit Aktiv dhe Komanda e Divizionit Rezervë) nuk u realizuan në praktikë. Kësisoj, zinxhiri i komandimit të reparteve të këmbësorisë (batalion, regjiment) e

Tiranës.

Krahas armatimit konvencional në përbërje të Ushtrisë Shqiptare ishte armatimi me flurudhë të përkulur, kalibra të ndryshëm të artilerisë së kohës e ndër to ishin edhe 6 formacione taktike, bateri, të topave malor

## TOPI MALOR 100 MM “SKODA” MOD-14/19

Ky top malor është prodhim çek i fabrikës së famshme “Skoda” në vitin 1914. Ka shërbyer për asgjësimin ose për dëmtimin e forcës së gjallë të kundërshtarit, të vendosur në vende të hapura ose në objekte mbrojtëse.

Ka hyrë në inventarin e armatimit të Fuqive Armate në periudhën e Republikës së Parë Presidenciale Shqiptare, 1925-1928.

Kjo tipologji topi malor ishte i vendosur mbi rrota prej druri të përpunuar në mënyrë që të mund të tërhiqeshin nga kafshë tërheqëse sidomos në vende malore.

Të dhënat taktiko-teknike të topit:

Kalibri: 100 mm

Gjatësia e tytës: 1.93 m

Pesha në pozicion zjarri: 1350 kg.

Pesha në pozicion lëvizjeje: 2025 kg.

Distanca maksimale e qitjes:



nga numri relativisht i pakët i njëjësive të këmbësorisë aktive e rezerviste, për vetë natyrën e përhapjes së tyre, si dhe për t'i pasur ato më mirë në

kapërceu hallkën e divizionit, duke u varur drejtpërdrejt nga Komanda e Përgjithshme. Në mbështetje të kësaj force, u krijua Spitali Ushtarak i

100mm “SKODA”, mod-14/19, një ekzemplar i vetëm ndodhet në Muzeun e Forcave të Armatosura, në “Garnizonin Skënderbej”.

8,400 m

Këndi i lartësimit: -8° në + 50°

Pesha e predhës: 14 kg.



## Siguria

Sekretari i Përgjithshëm ishte i pranishëm në Këshillin Atlantik, shtëpia e NATO-s në Uashington. Spektri i një konflikti të madh në Evropë është më i pranishëm sot se sa ka qenë në çdo kohë që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Ngritja e forcave ruse në kufijtë e Ukrainës është një kërcënim jo vetëm për integritetin territorial të atij vendi; është një sulm i drejtpërdrejtë ndaj normave ndërkombëtare të sovranitetit dhe vetëvendosjes kombëtare. Në këtë moment vendimtar, ne jemi të etur të dëgjojmë perspektivën e sekretarit të përgjithshëm për këtë krizë të krijuar nga Kremli në Ukrainë, se si NATO po reagon, implikimet për konceptin e ri strategjik të NATO-s dhe çfarë do të ndodhë më pas për vetë aleancën.

Kjo është intervista e parë e drejtpërdrejtë e sekretarit të përgjithshëm që kur NATO dhe Shtetet e Bashkuara dhanë përgjigjet e tyre me shkrim ndaj kërkesave të sigurisë të Moskës në dhjetor, pasi ai drejton aleancën në një nga momentet më të rrezikshme në historinë e fundit.

**MARGARET BRENNAN:** Mirëdita zoti Sekretar i Përgjithshëm. Nuk kam shumë nevojë t'ju prezantoj, por, për këdo që e shikon, Jens Stoltenberg është sekretar i përgjithshëm i NATO-s dhe ka qenë që nga tetori 2014, duke ndjekur një karrierë të shquar ndërkombëtare dhe vendase, si kryeministër i Norvegjisë dhe i dërguar special i OKB-së për ndryshimet klimatike.

Zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju keni një sfidë të jashtëzakonshme përpara jush në këtë moment. Ne kemi dëgjuar nga Rusia, në komunikimet e tyre publike deri më tani, se ajo që NATO dhe Shtetet e Bashkuara vendosën në tryezë nuk adresonin shqetësimet e tyre kryesore të sigurisë. Forcat ruse vazhdojnë të ndërtohen në rajon. Në këtë pikë, a mundet NATO të pengojë një pushtim rus të Ukrainës apo qëllimi juaj është thjesht të frenoni konfliktin që të mos kthehet në një luftë rajonale?

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM JENS STOLTENBERG:** Qëllimi ynë është, natyrisht, t'i përcjellim një mesazh të qartë Rusisë dhe kjo është pikërisht ajo që ne po bëjmë, se nëse ata përdorin forcën ushtarake kundër Ukrainës, kjo do të ketë pasojë të rënda. Aleatët e NATO-s janë gati të vendosin sanksione të rënda ekonomike – sanksione politike dhe financiare. NATO i jep mbështetje Ukrainës. Ne e ndihmojmë Ukrainën në modernizimin e institucioneve të saj të mbrojtjes dhe sigurisë dhe aleatët e NATO-s ofrojnë trajnime në këtë pajisje. Pra, Ukraina gjithashtu mund t'i imponojë kosto Rusisë nëse ajo, edhe një herë, pushton Ukrainën. Dhe pastaj, së treti, dhe më e rëndësishmja për aleatët e NATO-s, është se ne jemi gjithashtu të gatshëm të rrisim, siç bëjmë në fakt tani, praninë tonë ushtarake në pjesën lindore të aleancës për të parandaluar çdo keqkuptim apo hapësirë për llogaritje të gabuara. për aftësinë dhe gatishmërinë e NATO-s për t'u mbrojtur dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Pra, ne po bëjmë tre gjëra. Ne po dërgojmë një mesazh sanksionesh, çmim i lartë për t'u paguar, ne po mbështesim Ukrainën dhe po përcjellim gjithashtu angazhimin absolut dhe të palëkundur për të gjithë aleatët e NATO-s.

**MARGARET BRENNAN:** Por a keni parë ndonjë tregues konkret deri më sot se Rusia po tërhiqet?

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM JENS STOLTENBERG:** Ajo që kemi parë është një ngritje e vazhdueshme ushtarake nga Rusia dhe, natyrisht, kjo është diçka që ne e ndjekim me shumë vëmendje. Ata po vendosin më shumë trupa, më shumë pajisje të rënda, dhe tani gjithashtu mijëra trupa luftarake në Bjellorusi të pajisur me avionë, helikopterë dhe sisteme të avancuara të armëve, S-400 dhe sisteme të tjera të armëve. Kështu që ndërtimi ushtarak vazhdon. Në të njëjtën kohë, Rusia ishte e gatshme të takohet me ne - Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e NATO-s - disa javë më parë, dhe kjo është një shenjë e mirë që ne u ulëm në të njëjtën dhomë dhe për orë të tëra trajtuam situatën në dhe rreth Ukrainës dhe pasojat e sigurisë për të gjithë ne dhe për Europën, por edhe që tani kemi përcjellë propozimet tona me shkrim, se si ne besojmë se është e mundur të gjejmë bazë të përbashkët për çdo gjë, nga kontrolli i armëve të transparencës së aktivitetëve ushtarake e deri të linjat e komunikimit midis aleatëve të NATO-s dhe Rusisë. Dhe tani Rusia duhet t'i vlerësojë këto propozime, dhe ne jemi gati të ulemi me ta kur të jenë

## Jens Stoltenberg për agresionin rus, aftësitë e Ukrainës dhe zgjerimin e Aleancës

*Intervistë e Sekretarit të përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, nga Margaret Brennan, moderatore e “Face the Nation” dhe krye-korrespondente e Punëve të Jashtme, CBS News, për “Atlantic Council Front Page”*



gati të vazhdojnë përpjekjet për të gjetur një zgjidhje politike diplomatike.

**MARGARET BRENNAN:** Ministri i Jashtëm i Ukrainës tha sot se ata besojnë se mund të duhen dy javë të ardhshme për të vazhduar bisedimet. Mendoni se keni një kohë të tillë?

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM JENS STOLTENBERG:** Ne kemi atë kohë për sa kohë që Rusia nuk vendos edhe një herë të përdorë forcën ushtarake. Nuk ka siguri për planet ruse, dhe ndoshta ata nuk kanë marrë ndonjë vendim përfundimtar. Nga ana e NATO-s, ne jemi të gatshëm të përfshihemi në dialog politik, por jemi gjithashtu të gatshëm të përgjigjemi nëse Rusia zgjedh një konflikt të armatosur, një konfrontim. Pra, ne jemi gati për të dyja opsionet. Ne po punojmë shumë për zgjidhjen më të mirë politike paqësore, por jemi gjithashtu të përgatitur për më të keqen: Nëse Rusia, e përsëris, përdor forcën kundër një fqinji, Ukrainës.

**MARGARET BRENNAN:** Për sa i përket përgatitjes për më të keqen, ju thatë në fillim të kësaj jave se Forca e Reagimit të NATO-s, e cila është një forcë prej rreth pesë mijë, e cila mund të dislokohet brenda disa ditësh. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të veprimeve të mundshme që Rusia mund të ndërmarrë, saktësisht cili është pragu për vendosjen e tyre? A kanë rënë dakord aleatët saktësisht se çfarë do ta shkaktonte atë?

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM JENS STOLTENBERG:** Para së gjithash, Forca e Reagimit të NATO-s është vetëm një nga elementët në atë që ne bëjmë për të ofruar parandalim dhe mbrojtje të besueshme për të gjithë aleatët e NATO-s, dhe veçanërisht aleatët në lindje të aleancës. Ne tashmë, pasi Rusia përdori forcën kundër Ukrainës në vitin 2014, për herë të parë në historinë tonë kemi vendosur grupe luftarake të gatshme, grupe luftarake të NATO-s, në pjesën lindore të aleancës në vendet baltike dhe Poloni. Ne kemi policim ajror, si në rajonin e Detit të Zi ashtu edhe në rajonin e Balltikut. Ne kemi një prani më të madhe detare dhe gjatë javëve

të fundit kemi rritur numrin e avionëve dhe anijeve në këto misione të ndryshme. Pastaj kemi Forcën e Reagimit të NATO-s. Sasia totale e trupave atje është rreth dyzet mijë, por elementi kryesor i Forcës së Reagimit të NATO-s është saktësisht, siç thoni ju, rreth pesë mijë. Ky është një vendim politik. Ne do të vlerësojmë dhe do t'i marrim vendimet tona kur të shohim nevojën për të rritur më tej praninë në lindje, ose duke vendosur të gjithë elementët e Forcës së Reagimit të NATO-s, në varësi të situatës, dhe gjithashtu po konsiderojmë të dislokojmë ose të ketë grupe beteje, jo vetëm në vendet baltike dhe në Poloni, siç kemi tani, por edhe Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe aleatët e tjerë kanë treguar gjithashtu një gatishmëri për të pasur grupe të ngjashme beteje në rajonin e Detit të Zi nën komandën e NATO-s si pjesë e pranisë së NATO-s. Pastaj gjithashtu, për herë të parë në dekada, ne kemi një aeroplanmbajtëse të SHBA-së nën komandën e NATO-s dhe kemi më shumë mjete detare dhe ajrore në rajon në dispozicion nëse është e nevojshme.

**MARGARET BRENNAN:** Për sa i përket asaj përgjigjeje të shpejtë, forca e reagimit për të cilën folët, pesë mijë, aktualisht drejtohet nga Franca së bashku me trupat aleate në të. Franca është tre muaj larg zgjedhjeve presidenciale. A jeni i shqetësuar se politika do të komplikojë gatishmërinë për t'u përgjigjur? Ju thatë se është një vendim politik për të marrë votën për vendosjen e tyre. Jeni i shqetësuar?

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM JENS STOLTENBERG:** Franca është një aleate shumë e përkushtuar e NATO-s, e cila ka aftësi të nivelit të lartë. Franca ka demonstruar gjithashtu gjatë shumë viteve aftësinë për të vendosur forca, nëse është e nevojshme, për t'u përfshirë në konflikte të vështira dhe për të trajtuar shumë situata sfiduese. Kështu që unë jam absolutisht i bindur se Franca, por edhe aleatët e tjerë në elementët kryesorë që ne i quajmë VJTF, elementët kryesorë të Forcës së Reagimit të NATO-s, do të jenë gati të vendosen, nëse është e nevojshme. Por ne jemi në të njëjtën

kohë duke ndjekur rrugën diplomatike sepse zgjidhja më e mirë do të jetë parandalimi i çdo ndërhyrjeje në Ukrainë. Dhe për këtë arsye, ne po dërgojmë mesazhe të forta se pasojat e rënda janë një çmim i lartë për Rusinë, por edhe fakti që tani kemi parë një mbështetje të shtuar për Ukrainën. Kanada ja sapo njoftoi, për shembull, më shumë trajnerë në Ukrainë. Pra, trupat ukrainase, ushtria ukrainase, është shumë më mirë e trajnuar, shumë më mirë e pajisur dhe shumë më e gatshme se sa ishin në vitin 2014. Dhe sigurisht, kjo me të vërtetë i imponon kosto Rusisë, nëse ata vendosin të lëvizin sërish në Ukrainë.

**MARGARET BRENNAN:** Është e drejtë që Ukraina të mbrohet, por siç e dini, diplomacia është më e fuqishme kur ka një përdorim të besueshëm të forcës pas saj, prandaj kjo është arsyeja pse po ju pyes për atë vendim. Dua të them, nëse duhet të hidhet në votim mes aleatëve, a keni besim? A e dini se cili është ai prag që do t'i detyronte të gjithë aleatët të bien dakord të përdorin atë forcë reagimi?

## Ministria Petrovska: Së bashku kemi arritur shumë, por do të vazhdojmë të jemi ambiciozë dhe të gjejmë rrugë për një numër edhe më të madh të aktiviteteve dhe stërvitjeve të përbashkëta

“Maqedonia e Veriut dhe Mbretëria e Bashkuar kanë bashkëpunim jashtëzakonisht intensiv në Mbrojtje dhe ne synojmë të vazhdojmë ta zhvillojmë atë. Së bashku kemi arritur shumë, por do të vazhdojmë të jemi ambiciozë dhe të gjejmë rrugë për një numër edhe më të madh të aktiviteteve, ushtrimeve, trajnimeve, stërvitjeve të përbashkëta dhe jam e bindur se do ta arrijmë këtë sepse ka një vullnet të sinqertë për bashkëpunim dhe mbështetje nga të dyja palët”, -tha ministria e Mbrojtjes Sllavjanka Petrovska në takimin e saj të parë me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Rejçel Gallouej. Ambasadorja Gallouei tha se Mbretëria e Bashkuar ka mbështetur fuqishëm Maqedoninë e Veriut në rrugën e saj drejt NATO-s dhe pas anëtarësimit në Aleancë bashkëpunimi mes dy vendeve në disa fusha, veçanërisht në fushën e mbrojtjes është thelluar. “Ky bashkëpunim nuk do të humbasë ritmin e tij në të ardhmen”, -tha Gallouej.

Petrovska dhe Gallouej diskutuan gjithashtu situatën rreth Ukrainës. Ato përshëndetën unitetin e aleatëve të NATO-s në këtë kontekst, si dhe përpjekjet për të gjetur një zgjidhje diplomatike për situatën komplekse. Maqedonia e Veriut dhe Mbretëria e Bashkuar bashkëpunojnë në fushën e trajnimeve dhe në atë drejtim është themeluar Celula Koordinuese e përbërë nga oficerë britanikë me të cilët bashkëpunojmë në zhvillimin e poligonit Krivollak si kapacitet i dobishëm kombëtar dhe i NATO-s. Trupat britanike do të jenë pjesë e stërvitjes “Swift Response 22”, e cila është stërvitja më e madhe ushtarake që do të mbahet këtë vit në poligonin Krivollak.

Mbretëria e Bashkuar gjithashtu ndihmon dhe mbështet transformimin e Armatës në përputhje me standardet e Aleancës nëpërmjet këshilltarit britanik, gjeneral brigade Xhon Bauron, i vendosur në Ministrinë e Mbrojtjes.





Drejtori i NALT, gjeneral brigade Jörg Rüter, vlerësoi lart takimin e sotëm si një mundësi e mirë për të vlerësuar dhe diskutuar aktivitetet e realizuara deri më tani dhe aktivitetet e planifikuara për të ardhmen. Në vijim, gjenerali Rüter ftoi ekspertët nga Bullgaria, Dr. Velizar Shalamanov dhe Irena Mladenova që të bëjnë një prezantim përmes video-linkut mbi menaxhimin e ndryshimeve organizative në administratën shtetërore.



Takimi i Lidershipit të Lartë të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe NALT-it

**M**e qëllim të koordinimit të përpjekjeve këshillimore, sot u mbajt takimi i Lidershipit të Lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT).

Me këtë rast, në fjalën e tij hyrëse, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, theksoi se ky takim ruan kohezionin e koordinimit të suksesshëm të aktiviteteve që mundësojnë realizimin me sukses të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ai e vlerësoi mbështetjen e NALT-it si të një rëndësie të madhe në të gjitha arritjet e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, dhe për këtë falënderoi dhe shprehu mirënjohjen e lartë për drejtorin e NALT-it, gjeneral brigade Jörg Rüter dhe ekipin e tij.

Drejtori i NALT, gjeneral brigade Jörg Rüter, vlerësoi lart takimin e sotëm si një mundësi e mirë për të vlerësuar dhe diskutuar aktivitetet e realizuara deri më tani dhe aktivitetet e planifikuara për të ardhmen.

Në vijim, gjenerali Rüter ftoi ekspertët nga Bullgaria, Dr. Velizar Shalamanov dhe Irena Mladenova që të bëjnë një prezantim përmes video-linkut mbi menaxhimin e ndryshimeve organizative në administratën shtetërore.

# Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj: Kohezion dhe koordinim i suksesshëm i aktiviteteve për realizimin e objektivave



**K**ryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, është pritur në takim nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Në takim u diskutua për zhvillimet politike në Kosovë dhe në rajon, duke i vënë theks të veçantë sfidave të ndikimit rus dhe serb ndaj paqes dhe stabilitetit në rajon.

Në një komunikatë nga Presidencia, thuhet se Osmani ka theksuar se perspektiva e të dy shteteve është në Bashkimin Europian dhe në këtë kontekst, thuhet se ka potencuar që Kosova tashmë ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave për çka BE-ja duhet të mbajë fjalën kundrejt qytetarëve të Kosovës.

Ajo veçoi raportet e mira fqinjësore me Maqedoninë e Veriut, për të cilat një kontribut të çmuar japin edhe shqiptarët si urë lidhëse ndërmjet dy shteteve.

## Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani: Raportet e mira fqinjësore me Maqedoninë e Veriut, falë edhe kontributit të çmuar që japin shqiptarët si urë lidhëse ndërmjet dy shteteve





# Shqipëria, perla e Mesdheut

Përgatiti: Shefe e Sektorit të Botimeve Anjeza Musollari

“Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë, po shumë të mirë, jo të lartë, po shumë të lartë, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t’i vëmë shpirtit të Kombit themele të shëndoshë”, - Lasgush Poradeci.

Mbi zall të pyllit vjeshtarak  
Dremit liqeri pa kufi,  
Ay ndaj fundesh u përflak  
Posi me zjarr e me flori.

Tashi po shuhet nënë mal,  
Qytet’i ngrysur në zi.  
Po ndizen yjtë dal-nga-dal  
Plot bukuri! plot fshehtësi!

Nuk di pse shpesh më ngatërrohen, i madhi Lasgush e pagëzoi me emrin Poradec apo Poradeci i dha emrin “patriarkut të lirikës shqiptare”.

Por një gjë është e sigurt Llazar Gusho u ngjiz në dallgët e liqenit të Pogradecit, në liqenin e Ohrit, aty ku oshtima e ujit sjell qetësi, ku mali dashurisht gërryhet prej dallgëve të liqerit.

Për të kombi ishte gjithçka për të qenë vetvetja me një personalitet. “Në këtë komb ka zakon, traditë, tradicion domethënë Komb, domethënë Nacion, domethënë njeri i vetëdijshëm, njeri që e di veten e vet, që e njeh vetveten.”-L. Poradeci.

Fije fije poezie  
Që mban era Shqipërie

Liqeni i Pogradecit të ofron si me magji gjithçka që plotëson kultura e qytetit të Pogradecit me njerëzit e saj me edukatë dhe të urtë. Liqeni të ofron, si paqe, dhe qetësi, arratisje nga e tashmja, bukuri dhe shumë vargje që notojnë nën vjershat e të madhit Lasgush Poradeci.

Uji të plazmon romantikë në personalitet, vëmendjen dhe inteligjencën, ta dëgjosh oshtimën e tij ndër dallgë, zjarri të bën energjik dhe pasionant, ajri të bën dinamik nën ritmin e veçantë të rimës së Lasgushit për njeriun, natyrën, kombin.

Mjafton të lexosh vargjet e Lasgushit dhe ke njohur këtë qytet të paqte në të gjithë dimensionet historike, kulturore, njerëzore. Panoramën për këtë perle të juglindjes e sjellim në vëmendjen e atyre skeptikëve që ende nuk kanë shijuar bukuritë shqiptare.

Pogradeci është i bukur jo vetëm prej natyre, por është edhe një qytet i lashtë e me tradita të hershme kulturore e artistike. Pogradeci është qyteti i luleve, i verës, i peshkut të rrallë koranit, që vështirë se gjendet tjetër kund, por edhe qyteti i mikpritjes. Pogradeci ka një histori të lashtë dhe dokumente të shumta kulturore, gjeologjike dhe natyrore. Ai është banuar në periudhën e paleolitit, ku në Buqezë u ngritën vendbanimet e para palafite. Ndërkohë gërmimet arkeologjike në kodrën mbi qytet kanë zbuluar një vendbanim ilir të shekullit V p.e.s., që i përket fiseve të lashta të Desaretëve që në atë kohë, popullonin Mokrën e sotme dhe Enkelejdit. Këta të fundit kanë qenë fis që kanë jetuar brenda mureve të kalasë së ndërtuar në majë të kodrës pranë qytetit, në pjesën veri-perëndimore të tij. Qytetet e tyre Pelioni dhe Enkelana u shndërruan në shekujt IV-III p.e.s. në qendra të rëndësishme urbane. Dikur qyteti kishte dimensionet e kalasë, ku tashmë gjenden vetëm rrënojat. Me rritjen e popullsisë dhe mbarimit të luftërave lindi nevoja e zgjerimit. Gjatë shekujve në vazhdim banorët e fshatit zbritën poshtë në rrëzë të kodrës dhe krijuan qytetin e Pogradecit, përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit. Zbulimet



arkeologjike, që konfirmojnë popullimin në këtë rajon, datojnë nga Periudha Neolitike (6000 vjet p.e.s.), me popullsi dhe ndërtime në rritje gjatë periudhave të Bakrit, Bronzit dhe Hekurit. Gjatë Mesjetës së mesme në shekujt IX-XI, Pogradeci kaloi periudhën e pushtimit bullgar, nga e cila ka trashëguar një sërë toponimesh sllave, madje dhe emrin Pogra-Dec, që do të thotë “qyteti nën kështjellë”, pasi edhe sot qyteti ndodhet nën kështjellën e lashtë mesjetare. Pogradeci ka një traditë shumë të pasur folklori, me larmi kostumesh popullore dhe këngë e valle melodioze të frymëzuara nga bukuritë natyrore të zonës. Tradita artistike e Pogradecit ka prodhuar shumë piktorë dhe shkrimtarë të poezisë dhe prozës, si Lasgush Poradeci, lirikë më i madh shqiptar, Mitrush Kutelin. Elementë artistikë mund t’i gjejmë edhe në arkitekturën e qytetit. Pogradeci me një traditë të pasur në artizanat përfaqësohet sot denjësisht nga artistët e gdhendjes në dru. Pogradeci ka një muze të pasur me dëshmi antikiteti dhe të kohës së luftës, ka kishën e vjetër ortodokse, që quhet kisha e Shën Mërisë dhe ndodhet në lagjen e vjetër të qytetit, si dhe një kishë të re, me arkitekturë shumë të veçantë të quajtur Ringjallja.

**Pogradeci, qyteti me njerëz që kanë lënë gjurmë në histori**

Reshit Çollaku, lindi në Pogradec, më 1914, ku mbaroi dhe shkollën fillore. Më vonë vazhdoi mësimet në Tiranë. Pas kësaj kaloi në gjimnazin ushtarak në Romë. Vitet e fundit i bëri në Akademinë Ushtarake të Modenas në Itali, ku e gjeti edhe pushtimin i Atdheut nga hordhitë fashiste. Kjo ngjarje e kobshme e tronditi dhe e trishtoi së tepërmi sepse u shkel liria. Më 12 prill 1939, Komanda e Akademisë, në mënyrë pompoze organizon një mbledhje, gjoja me të gjithë shqiptarët, që të bënin betimin ushtarak para dy flamurëve shqiptarë dhe flamurëve italiane me sëpatat e fashizmit. Komandanti i Akademisë mori fjalën nga Koloneli dhe përshëndeti. Kur filloi t’u flasë oficerëve shqiptarë se ata duhet të krenoheshin për ata flamuj, Reshiti iu

përgjigji: “Ne do të krenohemi me flamurin tonë kur ta mbrojmë me gjokset tona dhe kur ta shohim këtu në Itali, të mbajtur nga duart e ushtarëve shqiptarë, si në kohën kur Skënderbeu i erdhi në ndihmë Ferdinandit të Napolit, dhe jo të rrethuar nga bajonetat tuaja”. Më pas Koloneli i ftoi të gjithë ushtarakët shqiptarë të betohen, duke thënë “Lo giuro”, por ata nuk e pasuan. Gjenerali i tha Kolonelit: “A dinë italisht këta apo jo?”. Në këmbim të fjalëve të betimit, Reshiti foli përsëri: “Nuk na gënjeni me propagandën tuaj”, dhe më pas vijoi: “Unë jam betuar një herë për Shqipërinë dhe një betim të dytë e quaj të turpshëm dhe korruptonjës”. Mbas bojkotimit të mësimet për tre ditë ata u mblodhën përsëri. Koloneli i ftoi përsëri për të bërë betimin përpara flamurit kombëtar, por askush nuk del përpara për t’u betuar. Atmosfera elektrizohet,



gjokset filluan të ndizen, të gjithë i kanë sytë tek Reshiti, por ky tashme nuk është në vendin e tij. Duke lënë shokët pas, i qetë, i sigurt, plot vendosmëri,

me kokën lart e sytë drejtuar në fytyrën e oficerit fashist, Reshiti filloi të flasë: “Na ndjeni zotërinj, ky flamur nuk është i yni. Për çdo shqiptar të vërtetë është krejt i huaj, prandaj ne s’kemi pse të betohemi përpara një cope bezeje të kuqe që ka aq vlerë sa edhe copat e bezeve me të cilat mbështjellim këmbët”. Reshiti u përkrah edhe nga disa shokë të tjerë. Mbledhja u prish dhe Reshiti u vu në arrest. Pas disa ditësh erdhi në Shqipëri dhe në mënyrë ilegale kaloi kufirin për në Jugosllavi ku u takua me shqiptarë të tjerë të arratisur. Reshit Çollaku u vu në krye të forcave partizane në këto krahina dhe në krye të partizanëve mori pjesë në shumë luftime. Premtim i tij gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte: “Do t’i luftoj deri në fund pushtuesit italianë në këtë Luftë Çlirimtare, do të jem me popullin, miqtë dhe shokët e mi, që kanë rrëmbyer armët dhe luftojnë kundër fashistëve italianë këtu në Mokër dhe në gjithë Shqipërinë”. Reshiti kishte një kulturë dhe e njihte artin ushtarak. Ai ra heroikisht siç i ka hije bijve mokrarrë.

Pogradeci ka nxjerrë nga djepi i vet bij dhe bija që kane shënuar me gjurmën e vet, siç është dhe Ing. Myfit Guxholli, i cili ka përgatitur cikle të plota të leksioneve ushtarake në gjeodezinë e lartë, në gjeodezinë inxhinierike si dhe leksionet e gjeografisë ushtarake për Akademinë e Mbrojtjes dhe atë “Skënderbej”. Në vitin 1986 boton tekstin mësimor “Gjeodezia” të përshatur për studentët e specialitetit topograf në Akademinë “Skënderbej”, por dhe për studentët të tjerë të specialiteteve të ndryshme që studiojnë në këtë Akademi gjeodezinë, si xhenio etj. Po ashtu, ai është bashkautor i hartave të territorit shqiptar të shkallëve 1 : 25000 – 1: 50000 (projektet në IGU Tiranë). Ing. Myfit Guxholli, megjithëse në moshë fare i ri, që në shkurt 1944 u rreshtua në radhët e Ushtrisë partizane në Brigadën IV Salmuese, si kuadër i kësaj brigade. Mbas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, me hapjen e shkollës “Skënderbej”, mbaron me rezultate të mira dy vite mësimore të kësaj shkolle dhe më pas mbaroi Shkollën e Lartë të Topografisë Ushtarake në Leningrad (ish-Bashkimi Sovjetik). Pas diplomimit u emërua në Degën e Topografisë në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Krahës detyrës së tij funksionale, ai vazhdoi studimet edhe në Fakultetin e Inxhinierisë së Universitetit të Tiranës, në mbarim të të cilit u titullua “Inxhinier topograf”. Ai ka kryer detyra të rëndësishme në Ushtri. Pasi u gradua nëntoger u emërua kryetopograf, më vonë shef seksioni dhe nënkryetar Dege të Topografisë pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Gjatë viteve 1952-1961 ka marrë pjesë në organizimin, projektimin dhe zbatimin në terren të të gjitha punimeve topogjeodezike për sigurimin topografik të Ushtrisë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Është bashkautor, së bashku me specialistët e huaj në projektimin e zbatimin në praktikë në terren të triangulacionit

shtetëror (arshiva IGU/1954). Nga viti 1961 deri në 1985 shërbeu në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve (sot Akademia “Skënderbej”) si pedagog, shef cikli dhe shef i Katedrës së Topografisë, me gradë “Major”. Gjatë kohës së mësimdhënies dhe drejtimit të Katedrës në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, Ing. Myfit Guxholli ka një aktivitet të pasur shkencor e pedagogjik. Qytet krenar për bijtë e vet!

**Turizmi**

Qyteti liqenor mbetet nga më mikpritësit në Shqipëri. Pamja mbresëlënëse dhe ujërat e kristaltë që të ofron liqeni e bëjnë Pogradecin një nga qytetet më të vizituara nga turistët vendas dhe të huaj. Pogradeci dhe rrethinat e tij janë një atraksion i përhershëm turistik për natyrën, kulturën dhe historinë që i japin madhësinë, ndërsa Liqeni hijeshinë. Pogradeci mbetet një nga qytetet më elitare të Shqipërisë, me kulturën, traditën dhe bukuritë natyrore, ku vizitori gjen prehje në të katër stinët e vitit.

Atraksionet janë të shumta në Pogradec, duke nisur nga qendrat historike, kulturore, qyteti i vjetër, kalaja 2400 vjeçare, Bazilika e Linit, varret mbretërore të Selcës, e në vetvete liqeni i Pogradecit, që tashmë është trashëgimi e UNESCO-s. Këto të gjitha e bëjnë Pogradecin që të jetë një qendër e turizmit kulturor dhe natyror.

Të shumtë janë turistët që e zgjedhin këtë qytet jo vetëm për plazhin, por edhe për pikat turistike Tushemishti dhe Driloni. Tushemishti, veç bukurisë natyrore dhe kulinarisë që të ofron, është bërë i njohur dhe i dashur nga të gjithë edhe me filmat “Zonja nga qyteti” dhe “Shoqja nga fshati”. Sot qytetarë të shumtë vizitojnë shtëpitë ku janë luajtur këto dy filma, ndërsa bëjnë foto me bustin e teto Ollgës.

Ndërkohë në lindje të Pogradecit ndodhet pika turistike e Drilonit, ku natyra nuk e ka kursyer bukurinë. Pemët e shumta dekorative dhe bimët e ndryshme janë në harmoni të plotë me ujërat e kristalta të lumit Drilon, rrugicat për shëtitje, urat karakteristike prej druri dhe zogjtë e bëjnë atë një nga vendet më të vizituara në këtë qytet. Qyteti i Pogradecit mbetet një destinacion i preferuar për turistët edhe në stinën e dimrit, sidomos kur ka reshje dëbore. Pamja piktoreske e liqenit dhe borës, i japin qytetit një sfond të mrekullueshëm.

Kulinaria është një tjetër atraksion për Pogradecin. Turistët përveçse për të shijuar magjinë e qytetit, vijnë edhe për kuzhinën tradicionale. Më i preferuari mbetet peshku koran, simboli i Pogradecit, por duke mos lënë pas edhe Belushkën, që i freskët gatuhet në mënyrë nga më të ndryshmet. Pogradeci, Tushemishti dhe Driloni për natyrën, kulinarinë, mikpritjen dhe liqenin që i fal gjithë hijeshinë, mbetet një atraksion që duhet shijuar.



# Deklaratë e përbashkët e presidentes së KE-së Ursula von der Leyen dhe presidentit të SHBA-së Biden për bashkëpunimin SHBA-BE për sigurinë energjetike

Deklarata e përbashkët e presidentes së Komisionit European Ursula von der Leyen dhe presidentit të SHBA-së Biden për bashkëpunimin SHBA-BE rreth ndryshimeve klimatike dhe politikën e energjisë, dekarbonizimit dhe sigurinë e furnizimit në Këshillin e Energjisë SHBA-BE.

Ne jemi të përkushtuar bashkërisht për sigurinë dhe qëndrueshmërinë energjetike të Europës dhe për përshejtimin e tranzicionit global drejt energjisë së pastër. Ne gjithashtu ndajmë objektivin për të garantuar sigurinë energjetike të Ukrainës dhe integrimin progresiv të Ukrainës me tregjet e gazit dhe energjisë elektrike të BE-së.

BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë për politikën e energjisë, dekarbonizimin dhe sigurinë e furnizimit në Këshillin e Energjisë SHBA-BE. Angazhimet e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara për të përmbushur qëllimet e Marrëveshjes së Parisit, përmes energjisë së pastër, veçanërisht burimeve të rinovueshme, efikasitë të energjisë dhe teknologjive, ofrojnë një rrugë drejt sigurisë së energjisë dhe uljes së varësisë nga lëndët djegëse fosile. Sfidat aktuale për sigurinë europiane nënvizojnë angazhimin tonë për të përshejtuar dhe menaxhuar me kujdes kalimin nga lëndët djegëse fosile në energji të pastër. Gjatë dekadës së fundit, BE ka investuar në diversifikimin e furnizimit nëpërmjet infrastrukturës dhe përforsimit të rrjeteve të saj të brendshme të energjisë, duke rritur elasticitetin dhe fleksibilitetin e tregjeve të energjisë të BE-së. Komisioni European do të intensifikojë punën me Shtetet Anëtare për sigurinë e furnizimit, brenda tregjeve transparente dhe konkurruese të gazit në një mënyrë të pajtueshme me qëllimet afatgjata të klimës dhe arritjen e emetimeve neto zero, deri në vitin 2050.

Ndërsa ky proces intensifikohet gjatë kësaj dekade kritike, ne jemi të përkushtuar të punojmë ngushtë së bashku për të kapërcyer sfidat e sotme të sigurisë së furnizimit dhe çmimeve të larta në tregjet e energjisë.

Ne angazhohemi të intensifikojmë bashkëpunimin tonë strategjik energjetik për sigurinë e furnizimit dhe do të punojmë së bashku për të vënë në dispozicion furnizime energjetike të besueshme dhe të përballueshme për qytetarët dhe bizneset në BE dhe fqinjët e saj.

Shtetet e Bashkuara dhe BE po punojnë së bashku drejt furnizimit të vazhdueshëm, të mjaftueshëm dhe në kohë të BE-së me gaz natyror nga burime të ndryshme anembanë globit për të shmangur goditjet e furnizimit, përfshirë ato që mund të rezultojnë nga një pushtim i mëtijshëm rus i Ukrainës. Shtetet e Bashkuara janë tashmë furnizuesi më i madh i gazit natyror të lëngshëm (GNL) në BE. Ne jemi duke bashkëpunuar me qeveritë dhe operatorët e tregut për furnizimin me vëllime shtesë të gazit natyror në Europë nga burime të ndryshme anem-



banë globit. Gazi natyror i lëngshëm në afat të shkurtër mund të rrisë sigurinë e furnizimit ndërkohë që ne vazhdojmë të mundësojmë kalimin në emetimet neto zero. Komisioni European do të punojë për përmirësimin e transparencës dhe përdorimit të terminaleve GNL në BE.

Ne synojmë të punojmë së bashku, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare të BE-së, për furnizimet me GNL për sigurinë e furnizimit dhe planifikimin e rasteve. Ne gjithashtu do të shkëmbejmë mendime për rolin e ruajtjes në sigurinë e furnizimit.

Më gjerësisht, ne u bëjmë thirrje të gjitha vendeve prodhuese kryesore të energjisë që të bashkohen me ne për të siguruar që tregjet botërore të energjisë të jenë të qëndrueshme dhe të furnizuara mirë. Kjo punë tashmë ka filluar dhe ne do ta çojmë përpara në takimin e Këshillit të Energjisë SHBA-BE, më 7 shkurt.

## EUROBAROMETRI SPECIAL 513 - NDRYSHIMET KLIMATIKE

# E ardhmja e Europës: Europeanët e shohin ndryshimin e klimës si sfidën kryesore për BE-në

Parlamenti European dhe Komisioni janë duke publikuar një Eurobarometër Special të përbashkët për të Ardhmen e Europës.

Eurobarometri është një seri sondazhesh të opinionit publik të kryera rregullisht në emër të Komisionit European dhe institucioneve të tjera të BE-së që nga viti 1973. Këto sondazhe trajtojnë një gamë të gjerë çështjesh aktuale në lidhje me Bashkimin Ndryshimet klimatike

Europeanët sipas Barometrit Special e identifikojnë ndryshimin e klimës si problemi i vetëm më serioz me të cilin përballet bota në tërësi. Për më tepër, gati gjysma e europianëve e konsiderojnë ndryshimin klimatik si një nga problemet më serioze me të cilat përballet bota, pas varfërisë, urisë dhe mungesës së ujit të pijshëm, por përpara përhapjes së sëmundjeve infektive. Është një rezultat i habitshëm në kuadër të pandemisë së koronavirusit, duke treguar nivelin e lartë të shqetësimit rreth ndryshimeve klimatike pavarësisht krizës serioze shëndetësore botërore në dekada. Në të vërtetë, proporcioni e europianëve që mendojnë se problemi i ndryshimit të klimës është shumë serioz ka mbetur i qëndrueshëm që nga viti 2019, në gati tetë në dhjetë.

Nëntë nga 10 të rinj europianë pajtohen se trajtimi i ndryshimeve klimatike mund të ndihmojë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre (91% e 15-24-vjeçarëve), ndërsa 87% e të gjithë të anketuarve ndajnë gjithashtu këtë mendim.

81% e të anketuarve thonë se janë të lumtur që jetojnë në BE.

68% e europianëve pajtohen se BE-ja është një vend stabiliteti në një botë të trazuar; ndërsa 67% pajtohen se projekti i BE-së ofron një perspektivë të ardhshme për rininë e Europës.

### E ardhmja e Europës

Me fillimin e vitit 2022 – Viti i caktuar European i Rinisë – ky sondazh nxjerr në pah pikëpamjet e të rinjve europianë mbi sfidat me të cilat përballet Bashkimi European, krahas rolit kyç që të rinjtë po luajnë në Konferencën për Ardhmërinë e Europës.

Eurobarometri tregon se 91% e 15-24-vjeçarëve besojnë se luftimi i ndryshimeve klimatike mund të ndihmojë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre, ndërsa 84% e atyre të moshës 55 vjeç e lart janë dakord. Pothuajse çdo i dyti european (49%) e sheh ndryshimin e klimës si sfidën kryesore globale për të ardhmen e BE-së, me mbështetje dërrmuese

për objektivat mjedisore të Marrëveshjes së Gjellbër Europiane: 88% e europianëve mendojnë se është e rëndësishme të rritet pjesa e burimeve të rinovueshme të energjisë në ekonominë tonë dhe të kemi efikasitet më të madh energjetik, ndërkohë që 80% bien dakord për rëndësinë e bërjes së Europës kontinenti i parë neutral ndaj klimës në botë deri në vitin 2050 dhe promovimi i rritjes së tregut të automjeteve me emetime zero dhe të ulëta.

Sfida të tjera globale të së ardhmes të theksuara nga të anketuarit përfshijnë shëndetin (34%) dhe migrimin dhe zhvendosjen e detyruar (të përmendura nga rreth 30%). Të kesh standarde jetese të krahasueshme (31%) dhe një politikë të përbashkët shëndetësore (22%) janë dy aspektet më të dobishme për të ardhmen e Europës. Europeanët gjithashtu kanë prioritet solidaritetin më të fortë midis Shteteve Anëtare (21%) dhe pavarësinë energjetike (20%).

### Pasuritë, sfidat dhe vlerat e BE-së

Katër sfidat më të përmendura me të cilat përballet vetë BE-ja janë pabarazitë sociale (36%), papunësia (32%), e ndjekur nga çështjet e migracionit (31%). Ashtu si me sfidat globale, çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike janë gjithashtu të larta në listën e sfidave me të cilat përballet BE-ja, të përmendura nga 32% e të anketuarve.

Europeanët e konsiderojnë respektimin e BE-së për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit (27%) si asetet kryesor të BE-së, të ndjekur nga fuqia e saj ekonomike, industriale dhe tregtare (25%), sipas të anketuarve.

### Jeta në Bashkimin European

Një shumicë e madhe e europianëve pajtohen se janë të lumtur që jetojnë në BE (81%) dhe në vendin e tyre (89%), si dhe janë të lumtur me jetën e tyre familjare (89%).

### Konferenca për të Ardhmen e Europës

Rreth 43% e europianëve thonë se përfitimi kryesor i përfshirjes së brezit të ri në Konferencë është fokusimi në çështjet me interes për ta. Përfitimet e mëtejshme të rolit të tyre kyç në Konferencë janë energjia dhe motivimi për reformat dhe ndryshimet që ato sjellin (cituar nga 35%) dhe fokusi i tyre për ta bërë të ardhmen e Europës më të përshtatshme me sfidat e shoqërisë së sotme (33%).

Qytetarët europianë mbeten vazhdimisht të interesuar për të kontribuar dhe për të marrë pjesë në Konferencën për Ardhmërinë e Europës. Ndërsa përgjigjia

në një sondazh është mjeti i preferuar për ta bërë këtë, siç tregohet nga më shumë se gjysma e europianëve (59%), pothuajse çdo i dyti qytetar european (46%) mund të pranojë të marrë pjesë në takime në zonën e tyre. Pjesëmarrja në konsultime online (40%), paraqitja e ideve dhe propozimeve për politikanë europianë dhe kombëtarë (39%) dhe pjesëmarrja në ngjarje kulturore dhe sportive europiane të lidhura me Konferencën (39%) janë format e radhës më tërheqëse të angazhimit të qytetarëve.

Në përgjithësi, europianët shohin ndryshimet klimatike dhe mjedisin (44%), shëndetin (40%), si dhe një ekonomi më të fortë, drejtësi sociale dhe punë (40%) si çështje kyçe për Konferencën.

Ekziston një pritshmëri e qartë se Konferenca duhet të çojë në rezultate të prekshme. Në të vërtetë, të anketuarit do të inkurajoheshin më shumë të merrnin pjesë në aktivitetet e Konferencës nëse do të ishin të bindur se pjesëmarrja e tyre do të kishte një ndikim real (53%).

### Zëri i qytetarëve në BE

90% e europianëve pajtohen që zërat e qytetarëve të BE-së duhet të merren më shumë parasysh në vendimet që kanë të bëjnë me të ardhmen e Europës. 55% e europianëve përmendin votimin në zgjedhjet europiane si një nga mënyrat më efektive për të siguruar që zërat të dëgjohen nga vendimmarrësit në nivel të BE-së.

Paralelisht me punën e vazhdueshme të Paneleve të Qytetarëve Europianë që miratojnë rekomandimet për Konferencën për Ardhmërinë e Europës, ky sondazh Special i Eurobarometrit 517 “E ardhmja e Evropës” ofron njohuri mbi pikëpamjet europiane dhe qëndrimet ndaj Konferencës për Ardhmërinë e Europës, dhe sfidat kryesore me të cilat përballet BE.

I porositur nga Parlamenti European dhe Komisioni, sondazhi u krye midis 16 shtatorit dhe 17 tetorit 2021 (vala EB 96.1) në 27 Shtetet Anëtare të BE-së. Anketa u krye ballë për ballë dhe u plotësua me intervista online, aty ku ishte e nevojshme si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Janë realizuar gjithsej rreth 26,530 intervista. Të gjithë europianët mund të ndajnë idetë e tyre se si të formësojnë të ardhmen e përbashkët në Platformën Dixhitale Shumëgjuhëshe të Konferencës për Ardhmërinë e Europës.

Eurobarometri Special është i disponueshëm në një uebsajt të ri të dedikuar të Eurobarometrit që ofron akses në anketat e Eurobarometrit dhe të dhënat e publikuara nga të dy institucionet që nga viti 1974.



# 4 shkurti dhe fjala masakër



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**M**ë 4 shkurt 1944, brenda disa orëve, humbën jetën 84 qytetarë të pafajshëm të Tiranës. 4 shkurti ishte dhe është simbol rezistence antifashiste, heroizmi e atdhedashurie, i cili në emër të rezistencës aktive antifashiste, me idealin e lirisë në zemër, lanë me gjakun e tyre rrugët e sheshet e Tiranës.

Ballistët me gjermanët, në fshehtësi me policinë sekrete, përgatitën listat e antifashistëve, të anëtarëve të njësiteve guerile, të familjeve, shtëpitë e të cilëve ishin bazat ilegale, të familjeve pjesëtarë të të cilëve kishin dalë partizanë, anëtarë të organizatës së rinisë, të gruas dhe të Fontit Antifashist Nacionalçlirimtar, të nacionalistëve patriotë, që u bënë pre e kësaj ndodhie të përbindshme. Në këtë natë u vranë 84 njerëz, por edhe një person të kishte rënë viktimë, përsëri ishte shumë. Turp që këtë masakër e bënë shqiptarët e armatosur ndaj shqiptarëve të paarmatosur dhe më turp akoma, kur të armatosurit ishin në shërbim të pushtuesit gjerman.

Sot pas 78 vitesh të kësaj ngjarjeje, ajo vazhdon të bëjë jehonë tek të gjithë brezat. Nuk di kur kjo padrejtësi, e që është një “masakër” tjetër, do të vendoset në vendin që i takon. Tirana e barrikadave, e lëvizjes më të madhe antifashiste në Shqipëri, e njësiteve guerile dhe e bazave të fuqishme të luftës, po zhvishet nga dita në ditë nga këto simbole, pavarësisht se ka ligje dhe vendime për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e tyre.

## Bashkëpunimi gjermano-ballist

4 shkurti ishte vazhdim i reprezaljeve dhe terrorit të ushtruar nga pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre ballistë. Ministri i Brendshëm, Xhaferr Deva, ka pasur kontakte të hershme me gjermanët që në Kosovë. Ky ishte një ministër i fuqishëm në qeverinë kuislinge shqiptare, i cili me mbështetjen dhe besimin e gjermanëve, gëzonte liri të plotë veprimi, ndërmerre veprime represive dhe ishte plotësisht në shërbim të tyre.

4 shkurti u bë si rezultat i disa atentateve të komunistëve kundër Xhaferr Devës dhe komandantit të Ballit Kombëtar Kadri Cakranit, më datën 3 shkurt 1944. Situata në Shqipëri në këtë kohë dhe nga ballafaqimi me dokumente gjermane, ngjarja e 4 shkurtit, lidhet me dhunën e trupave të milicisë së ministrit Deva, si dhe të operacioneve gjermano-balliste kundër lëvizjes partizane në periudhën nëntor 1943-shkurt 1944. Organizimi i 4 shkurtit, ishte një aksion i grupeve nacionaliste sipas dokumenteve gjermane.



Operacioni i Dimrit 1943-1944, i nisur prej gjermanëve në bashkëpunim me ballistët nuk e shoi lëvizjen partizane. Situata solli një stabilizim të përkohshëm të qeverisë së Rexhep Mitrovicës, njëkohësisht u forcua shpresa e ruajtjes së pushtetit të nacionalistëve dhe ballistëve pas largimit të gjermanëve. Në janar 1944 Mehdi Frashërit, Xhaferr Deva dhe Kadri Cakrani “i tmerrshmi” zhvilluan një mbledhje dhe përfshirjen e tre ballistëve në qeveri. Dokumenti gjerman thekson se “përfshirja e disa burrave në qeveri, të cilët janë përfaqësues të këtij fronti, është rezultat i luftës sonë të përbashkët me përkrahësit e Ballit Kombëtar në Shqipërinë e Jugut, të cilët të armatosur prej nesh, luftojnë kundër partizanëve të kuq. Bashkëpunimi i Wehrmacht-it tonë me formacionet e Kadri Cakranit në Shqipërinë e Jugut rezulton tepër i suksesshëm...”.

Misioni i ministrit të Brendshëm, Xhaferr Deva ishte “gjaku don gjak! Terrori kërkon terror! Terror kundër terroristëve, terror kundër anarkistëve, terror kundër nacionalçlirimtarëve, terror kundër simpatizantëve të saj”. Ndërsa regjenti Mehdi Frashëri theksonte luftë të hapur kundër komunistëve. Një dokument tjetër gjerman theksonte se “lufta e pandërprerë e bandave të Ballit Kombëtar kundër komunistëve në Shqipërinë e Jugut, të cilët ne i furnizojmë me armë dhe municione si edhe aksione të tjera të forcave nacionaliste në Shqipërinë Veriore dhe Lindore, i kanë dëmtuar rëndë kundërshtarët komunistë”. Në këto aksione u përfshinë forca të Ballit Kombëtar. Qeveria Mitrovica dhe Regjenca heshtën. Sipas gjermanëve, Mehdi Frashëri mbante një qëndrim oportunist, kurse Deva, mbështeste pa kufi kërkesat dhe interesat gjermane. Bashkëpunimi i ballistëve me pushtuesin nazist ishte i hapur.

Vrasjet e 4 shkurtit të vitit 1944 ndaj popullit të Tiranës ishte një ndër ngjarjet e hidhura të mbetura në kujtesën historike dhe sot, pas 78 vitesh. Sot ka interpretime që e shikojnë këtë ngjarje vetëm si një hakmarrje personale të ministrit Deva. Nisur

nga dokumente gjermane, del se vrasjet ishin vazhdim i aksioneve për llogari të gjermanëve dhe qeverisë shqiptare, të drejtuara nga ministri Deva. Aksionet kishin filluar në Pejë, në Prizren, në Shkodër dhe erdhën deri në Tiranë. Gjermanët i nxorën gështenjat nga zjarri, me duart e shqiptarëve. Terrori nuk e trembi popullsinë, por ajo u lidh më shumë me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Përkundrazi, antifashizmi fitoi më shumë dhe u zgjerua në të

liste planifikojnë gjatë natës kryerjen e një kundër-aksioni”. Ky operacion kishte synim që t’i jepte goditje të rëndë dhe asgjësuese komunistëve dhe Frontit Nacionalçlirimtar në Tiranë. Kjo ishte një kundërpërgjigje për dëmet që kishin pësuar forcat ushtarake gjermane dhe ballistët gjatë Operacionit të Dimrit 1943-1944 nga forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Do arrestoheshin dhe pushkatoheshin personat në listat e hartuara nga policia sekrete, duke filluar nga Gogo Nushi, komunistë, aktivistë të rinisë komuniste dhe të Frontit Nacio-



gjithë vendin. Nacionalizmi shqiptar dhe Balli Kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore dështuan dhe i krijuan kushte ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës.

## Operacioni u organizua dhe ishte tepër sekret

Dokumentet arkivore shqiptare dhe gjermane flasin se njerëzit u morën me forcë nga shtëpitë e tyre dhe në rrugë. Në këtë ndodhi, nazistë, kuislingë dhe ballistë kishin hartuar që më parë një skenar, në zyrën e Rexhep Mitrovicës, ku ishin Xhaferr Deva, Hysni Derna, Kadri Cakrani, Qazim Mulleti dhe oficerë nga gestapo gjermane. Një dokument gjerman thekson se “gjatë pasdites komunistët organizuan atentate ndaj drejtuesve nacionalistë. Ndër ta ishin ministri Deva dhe Cakrani (Kadri). Si pasojë, grupimet naciona-

nalçlirimtar, të gruas antifashiste, patriotë dhe pjesëtarë të njësiteve guerile. Do zbuloheshin dhe asgjësoheshin bazat ilegale të LANÇ-it, teknika e Partisë, strehimet ilegale, partizanë të plagosur, të sëmurë dhe këta të arrestoheshin e të pushkatoheshin.

Operacioni u organizua dhe ishte tepër sekret. Ai do fillonte pasditen e 3 shkurtit 1944 dhe mbyllej në orën 05.00 të mëngjesit, të datës 4 shkurt 1944. Operacioni drejtohej nga Xhaferr Deva dhe Kadri Cakrani. Forcat pjesëmarrëse në operacion ishin xhandarmëria, policia sekrete kuislinge, forcat e regjimentit mercenar “Kosovar” të ardhur në Shqipëri dhe forca të Ballit Kombëtar. Këto forca ishin të organizuar në grupe, ku secili grup kishte 10-15 ushtarakë në drejtime të caktuara. Në krye të tyre ishin agjentët e Gestapos, si dhe Qazim Mulleti, Osman Kukaleshi, Xhelal

Staravecka, Seit Matja, drejtues kryesor të organizatës së Ballit Kombëtar në Tiranë, Halim Begeja, Halil Mëniku, Seit Deneri, Arif Merepeza, Osman Kazazi, Zige Hatipi etj.

Operacioni filloi në orët e pasdites së 3 shkurtit 1944. Në një njoftim nga ATSH thuhej se “në orët e para të kësaj dite, disa grupe terroriste kanë tentuar të bëjnë atentat kundër qeverisë, personaliteteve të larta shqiptare, kundër Xhaferr Devës, Kadri Cakranit dhe kanë sulmuar automobilat e tyre me bomba dhe revolver”. Menjëherë Xhelal Staravecka dhe Kadri Cakrani, filluan operacionin me agjentët e tyre në Tiranë e Re, arrestuan qytetarët Todi Shkurti, Vangjel Capo, Hasan Çeliku dhe Jani Koçi, të cilët ktheheshin nga puna në shtëpitë e tyre dhe i pushkatuan. Ndodhinë e justifikuan se këta kishin vranë një tregtar dhe kishin plagosur disa të tjerë. Pas ngjarjes, forca të xhandarmërisë, të policisë dhe të regjimentit mercenar “Kosovar”, vendosën patrulla në rrugët e Tiranës. U vendos ndalim-qarkullimi. Nga ora 02:00 e natës dhe deri në mëngjesin e 4 shkurtit, bastisën mjaft shtëpi, arrestuan mbi 500 qytetarë dhe 84 njerëz i pushkatuan. Pjesa më e madhe e tyre ishin antifashistë, aktivistë të Frontit Nacionalçlirimtar, të rinj komunistë dhe punëtorë që shkonin në punë herët në mëngjes. Në mes të të masakruarve ishin katër italianë dhe katër malazezë.

Kjo ishte nata ku Tirana u gjakos në mëngjesin e 4 shkurtit 1944.

Në rrugët dhe sheshet e Tiranës, ishin vranë para Sahatit dhe Xhamisë 12 punëtorë dhe 4 italianë, në fund të Boulevardit, afër maternitetit 4 malazezë, në rrugën e Pishës 3, para Xhamisë në rrugën e Kavajës 3, në rrugën e Shën Gjergjit 7, etj. Mjaft prej të vranëve u ishin prerë gishtat e duarve dhe rrëmbyer unazat dhe dhëmbët e florinjtit. Kufomat e të vranëve qëndruan deri në orën 10.00, pastaj xhandarmëria i dërgoi në morgun e spitalit. Ministri i Brendshëm dhe Komandanti i Ballit Kombëtar, bazuar në një listë që u përgatit prej tyre me ngut në pasditen e 3 shkurtit, vranë duke gdhirë 4 shkurti, 84 qytetarë të Tiranës. Të vranët nuk ishin të gjithë antifashistë dhe komunistë, shumica e tyre ishin qytetarë të thjeshtë.





Bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey-t thelbësor në modernizimin e Forcave tona të Armatosura

Ushtarakët shqiptarë po trajnohen  
nga kolegët e tyre amerikanë për  
përdorimin dhe mirëmbajtjen e  
dronëve të rinj ushtarakë

